



Republika e Maqedonisë së Veriut
Agjencia për Cilësi në Arsimin e Lartë
BORDI I EVALUIMI TË ARSIMIT TË LARTË

Në bazë të neneve 8, 9, 12, 13, 16 dhe 18 të Rregullores për standardet dhe procedurën për evaluimin dhe vetevaluimin e jashtëm ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 153/22), Bordi për Evaluim të Arsimit të Lartë shpall

KONKURS PËR ZGJEDHJEN E STUDENTËVE PËR REALIZIMIN E EVALUIMIT TË JASHTËM TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË DHE PROGRAMEVE STUDIMORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË VERIORE

Me qëllim të formimit të komisioneve profesionale për evaluim të jashtëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e me qëllim të krijimit të Regjistrimit të studentëve, Bordi për Evaluim të Arsimit të Lartë (në tekstin e mëtejshëm: Bordi për Evaluim) shpall Konkurs për paraqitjen e studentëve për realizimin e evaluimit të jashtëm të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve studimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Thirrje publike).

KUSHTET DHE KRITERIUMET PËR ZGJEDHJEN E STUDENTËVE

Për të realizuar evaluimin e jashtëm, nga rradhët e studentëve mund të zgjedhet personi i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- ka statusin e studentit të rregullt në ciklin e parë, të dytë ose të tretë të studimeve në vend;
- ka përvojë paraprake në evaluimin e institucioneve të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit dhe
- ka njohuri të gjuhës angleze.

AFATI DHE MËNYRA E PARAQITJES SË KANDIDATËVE NGA RRADHËT E STUDENTËVE

Afati i paraqitjes zgjatë 30 ditë, nga dita e shpalljes së Thirrjes publike.

Regjistrimi i kandidatëve kryhet përmes plotësimit të Formularit, i cili ndodhet në faqen e Agjencisë për Cilësi në Arsimin e Lartë (ACAL), në linkun që vijon:
<http://akvo.mk/docs/konkursi/Formular.docx>

Formulari i plotësuar dorëzohet i nënshkruar dhe i skanuar, në adresat elektronike që vijojnë: cvete.stefanovska@tfb.uklo.edu.mk dhe vlado.gicev@ugd.edu.mk.

Në rast nevojë për informata shtesë, kontaktoni personin për kontakt të Bordit për Evaluim, dr. Biljana Kuzmanovska, në adresën elektronike që vijon: bkuzmanovska@fznh.ukim.edu.mk.

TË DREJTAT DHE DETYRAT E KANDIDATËVE TË PARFAQITUR NGA RRADHËT E STUDENTËVE

Anëtarët e komisionit profesional lidhin marrëveshje me Agjencinë për Cilësi në Arsimin e Lartë (ACAL), në të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrimet e tyre.

- Anëtarët e komisionit profesional janë të obliguar që:
- të studiojnë të gjithë dokumentacionin që është dorëzuar nga ana e institucionit të arsimit të lartë;
 - të marrin pjesë në mbledhjet e komisionit profesional;
 - të marrin pjesë në vizitë të institucionit të arsimit të lartë;
 - të përgatisin raport individual nga evaluimi i jashtëm i institucionit;

- aktivisht të marrin pjesë në vlerësimin e institucionit dhe në përgatitjen e Raportit të evaluimit të jashtëm;
- të përgatisin përgjigje ndaj ankesës të shtruar nga ana e institucionit të arsimit të lartë;
- e vlerësojnë të vepruarit ndaj konstatimeve, nga ana e institucionit të arsimit të lartë, për të cilin është propozuar tërheqja e akreditimit të institucionit ose të programeve të caktuara të studimit;
- t'u përmbahen afateve të përcaktuara dhe të kryejnë detyra të tjera që lidhen me procesin e evaluimit, në përputhje me detyrat e ndara në mes të anëtarëve të komisionit.

Anëtarët e komisionit profesional nënshkruajnë deklaratë për konfidencialitet, mbrojtje dhe moszbulim të informacioneve të cilat do të dalin nga procedurat, si dhe deklaratë për mungesë të konfliktit të interesave.